



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 dhjetor 2016  
Nr. ref.:RK1020/16

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI164/15**

Parashtrues

**Sadat Lekiqi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ–UZVP. Nr. 22/2015, të 30 korrikut 2015**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues i kërkesës është Sadat Lekiqi, me vendbanim në Gadime të Ulët, Komuna e Lipjanit.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ–UZVP. Nr. 22/2015, të 30 korrikut 2015, në lidhje me Aktgjykimin A. A. nr. 24/2015 të Gjykatës së Apelit, të 9 marsit 2015, me Aktgjykimin A. nr. 494/2013 të Gjykatës Themelore, të 13 nëntorit 2014, dhe me Aktvendimin nr. 682/2013 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të 18 marsit 2013.
3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 shtator 2015.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve dhe i vendimit të kontestuar, me të cilin, sipas parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij nga neni 7 [Vlerat], nga neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], nga neni 24 [Barazia para Ligjit], nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nga neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nga neni 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], nga neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nga neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], nga neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 7, i Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 31 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), e cila kërkesë ishte regjistruar të njëjtën ditë me numër 164/15.
7. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.
8. Më 11 shkurt 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi pretendime shtesë në mbështetje të kërkesës së tij.
9. Më 28 korrik 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

10. Më 2 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues në vend të gjyqtarit Robert Carolan. Përbërja e Kolegjit shqyrtues ka mbetur e pandryshuar.
11. Më 16 nëntor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

12. Në një datë të pacaktuar në vitin 2010, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK) publikoi konkursin Nr. 13/2010, për vendin e punës “referent për ekzekutime” për disa gjykata komunale. Sa i përket kohëzgjatjes së kontratës së punës, në konkurs thuhej: “Këto pozita publikohen për kohë të caktuar në afat dy (2) vjeçar nga dita e themelimit të marrëdhënies së punës”.
13. Brenda afatit ligjor, parashtruesi i kërkesës aplikoi për vendin e lirë të punës në Gjykatën Komunale në Ferizaj, si dhe për një pozitë në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
14. Më 9 dhjetor 2010, parashtruesi ishte ftuar nga KGJK-ja në intervistë për vendin e punës në Gjykatën Komunale në Ferizaj.
15. Më 24 dhjetor 2010, parashtruesi ishte intervistuar për vendin e punës në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ndërsa, më 10 janar 2011, ai ishte njoftuar nga KGJK-ja se nuk ishte përzgjedhur për vendin e punës në Gjykatën Komunale në Ferizaj.
16. Më 24 qershor 2011, parashtruesi i kërkesës u njoftua se, më 27 qershor 2011, ai mund të fillonte punën në vendin e punës në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për të cilin vend pune ai ishte intervistuar më 24 dhjetor 2010.
17. Më 27 qershor 2011, parashtruesi i kërkesës nënshkroi kontratën e punës dhe filloi të punojë në vendin e punës për një periudhë provuese 3-mujore.
18. Pas përfundimit të periudhës provuese, parashtruesi pranoi vendimin për emërim më 30 shtator 2011 nga KGJK-ja për pozitën e nëpunësit civil të jokarrierës me vlefshmëri deri më 31 dhjetor 2012.
19. Më 19 dhjetor 2012, parashtruesi i kërkesës pranoi Vendimin nr. 03/118-930 nga Zyra e Drejtorit të KGJK-së për përfundimin e marrëdhënies së punës nga 31 dhjetori, pasi “ai kishte themeluar marrëdhënie të punës për kohë të caktuar, nga 27 qershori 2011 deri më 31 dhjetor 2012”.
20. Më 31 dhjetor 2012, parashtruesi parashtrroi ankesë në Komisionin për zgjidhje të kontesteve dhe të ankesave të KGJK-së, duke u ankuar se ai ishte trajtuar padrejtësisht, pasi që pretendohet se me vendimin për shkëputje të marrëdhënies së punës ishin shkelur kushtet e konkursit nr. 13/2010, të 10 nëntorit 2010, duke mos ia vazhduar marrëdhënien e punës për 2 vjet të plota.

21. Për shkak të faktit se Komisioni për zgjidhje të kontesteve dhe të ankesave pretendohet se nuk e ka shqyrtuar ankesën e parashtruesit (heshtjes administrative), ai iu drejtua me ankesën e 21 shkurtit 2013, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë (në tekstin e mëtejme: KPMSHCK), duke pretenduar se ai ishte trajtuar padrejtësisht dhe duke kërkuar nga Këshilli që ta anulojë vendimin e KGJK-së dhe ta detyrojë atë ta caktojë në vendin e punës ku ai kishte qenë para se të shkarkohej.
22. Më 18 mars 2013, me vendimin nr. 682/2013, KPMSHCK-ja konstatoi se ankesa e parashtruesit ishte e pabazuar dhe se pretendimi i ankimuar se ai ishte trajtuar padrejtësisht nga organi i punësimit, duke mos ia vazhduar marrëdhënien e punës deri në 2 vjet, ishte i pabazuar. KPMSHCK-ja gjithashtu theksoi se parashtruesi i kërkesës kishte nënshkruar me dëshirë aktemërimin ku ishin përmendur kushtet dhe kohëzgjatja e punës dhe, pas nënshkrimit të aktemërimin, ai kishte të drejtë të parashtrojë ankesë dhe të mos e nënshkruajë kontratën.
23. KPMSHCK-ja më tej arsyetoi se kërkesa e parashtruesit që të transferohej në një pozitë të nëpunësit civil të karrierës ishte e pabazuar, pasi që, *inter alia*, transferimi i nëpunësve civilë nga një pozitë me afat të caktuar në një pozitë me afat të pacaktuar bëhet vetëm në qoftë se hapet një vend i ri i punës.
24. Parashtruesi i kërkesës më tej parashtroi ankesë administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar anulimin e vendimit të KPMSHCK-së, nr. 682/2013.
25. Më 13 nëntor 2014, me Aktgjykimin A. nr. 494/2013, Gjykata Themelore e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit që ta anulojë vendimin e KPMSHCK-së dhe ta kthejë lëndën në rigjykim dhe rivendosje.
26. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, duke kontestuar ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore dhe zbatimit të gabuar të dispozitave procedurale.
27. Më 9 mars 2015, me Aktgjykimin A. A. nr. 24/2015, Gjykata e Apelit e hodhi poshtë kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, duke pasur parasysh se, bazuar në provat e administruara, është konstatuar pa mëdyshje se marrëdhënia e punës së palëve është themeluar dhe është shkëputur në pajtim me kushtet e përcaktuara në aktin e emërimit, për të cilat ishin pajtuar të dyja palët.
28. Më 9 mars 2015, parashtruesi parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm nga Gjykata Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
29. Më 30 korrik 2015, me Aktgjykimin ARJ-UZVD. nr. 22/2015, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën si të pabazuar, duke theksuar se “*pas marrjes në shqyrtim të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të aktgjykimit të goditur në pajtim me*

nenin 53, të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se kërkesa është e pa bazuar”.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht me këto nene: 7 [Vlerat], 21 [Dispozitat e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 102 [Parimet e përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], dhe 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave], si dhe me nenet 6 dhe 14 të KEDNJ-së, në lidhje me nenin 22 të Kushtetutës.
31. Përveç kësaj, parashtruesi numëron një varg shkeljesh të pretenduara të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, të Ligjit për Shërbimin Civil, të Ligjit të Punës, të Ligjit për KPMSHCK, të Ligjit për Gjykatat, të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe të Ligjit për Procedurën Kontestimore.
32. Sa i përket aktgjyqimeve të Gjykatës së Apelit [A. A. nr. 24/2015] dhe të Gjykatës Themelore [A. nr. 494/2013], parashtruesi pretendon se *“parashtruesi ka kërkuar mbrojtje gjyqësore para gjykatave të rregullta, përmes mjeteve juridike, por që nuk ka gjetur vlerësim profesional nga gjykatat me rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit”*.
33. Sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [ARJ-UZVD. nr. 22/2015], parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Gjykata Supreme vetëm ka përshtuar arsyetimet e gjykatave më të ulëta dhe asgjë më tepër, përkundër faktit se është shtuar edhe më tej shkelja e të drejtave dhe lirive individuale të garantuara me Kushtetutë”*.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

34. Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

36. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.*
37. Përveç kësaj, Gjykata rikujton rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:  
[...]  
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar..*
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:  
[...]  
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
38. Gjykata vëren se parashtruesi, në esencë, pretendon që Gjykata Supreme ishte bërë “përgjegjëse për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi që ka autoritet ligjor dhe kushtetues për mënjanimin e shkeljeve të bëra nga gjykatat e shkallëve më të ulëta si dhe nga organet administrative”. Në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi i referohet të drejtave të tij sipas dispozitave të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së, si dhe në bazë të ligjeve të Kosovës, siç u cek më lart.
39. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata që të konstatojë dëmin e pariparueshëm i cili i ishte shkaktuar atij me ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga pikëpamja profesionale dhe të ndërtimit të karrierës, si dhe dëmin material.
40. Si përmbledhje, parashtruesi i kërkesës e konteston interpretimin e mënyrës në të cilën gjykatat e rregullta kishin përcaktuar kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës dhe mënyrën në të cilën ato kishin aplikuar dispozitat e procedurës administrative dhe të drejtën materiale. Ky interpretim është dhënë nga gjykatat e rregullta në tri shkallë dhe përfundimi i tyre u arrit pas shqyrtimit të hollësishëm të të gjitha argumenteve të parashtruara nga parashtruesi i kërkesës.
41. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës përsërit në Gjykatë të njëjtat argumente që ai i kishte parashtruar në procedurë para gjykatave të rregullta, në veçanti, në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike dhe ligjshmërinë e vendimeve të gjykatave të rregullta.
42. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit

(ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

43. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih *Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM]*, Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
44. Me fjalë të tjera, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta.
45. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykim i 16 shtatorit 1996, para. 65, shih po ashtu, *mutatis mutandis*, rasti KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
46. Sa i përket rastit konkret, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin A. nr. 494/2013, të 13 nëntorit 2014, vlerësoi “*ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së [Ligji për Konfliktet Administrative] dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit [parashtruesit të kërkesës] është e pabazuar*”.
47. Kjo gjendje faktike, e vërtetuar nga Gjykata Themelore, dhe arsyet e dhëna për Aktgjykim [A. no. 494/2013] ishin aprovuar si të drejta nga Gjykata e Apelit, ndërsa Gjykata Supreme kishte vendosur që “*pas marrjes në shqyrtim të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të aktgjykimit të goditur [të Gjykatës së Apelit] në pajtim me nenin 53, të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se kërkesa është e pabazuar*”.
48. Në këtë mënyrë, parashtruesit të kërkesës i është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e procedurës të paraqesë argumente dhe prova të cilat i konsideronte të rëndësishme për rastin e tij.
49. Gjykata konsideron se të gjitha argumentet e parashtruesit, të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit, janë dëgjuar në mënyrë të duhur dhe se gjykatat i kishin shqyrtuar në mënyrë të drejtë, se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që parashtruesi e kundërshton janë paraqitur hollësisht dhe se procedura pranë gjykatave të rregullta, shikuar në tërësi, ishte e drejtë.
50. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë.
51. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullit 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2016, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Ivan Čukalović

Arta Rama-Hajrizi

